



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1257/1 Prot.

Tiranë, më 17 / 09 / 2020

V E N D I M

Nr. 111, Datë 17 / 09 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 54, datë 15.06.2020, të S.T kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Elbasan (DRSHSSH Elbasan), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Djali i saj², që në moshën 2-vjeçare është diagnostikuar me “surdmutizëm” dhe deri në muajin dhjetor 2019 është trajtuar me KEMP. Në muajin janar 2020 i është ndërprerë përfitimi i KEMP-it me arsyen se djali vazhdon arsimin e mesëm pranë shkollës artistike “Onufri”, në degën pikturë, dhe se aftësia e tij mendore është pengesë për të. Ankuesja shprehet se vendimi i marrë nga DRSHSSH Elbasan për ndërprerjen e KEMP-it, i ka hequr djalit të saj të drejtën për të vazhduar shkollën dhe për tu zhvilluar, për arsye se ata si prindër nuk janë në gjendje për ta mbështetur ekonomikisht”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rivendosjen e trajtimit si person me aftësi të kufizuara.

¹ Ankuesja ka cituar dhe aftësinë e kufizuar.

² F.T, lindur në datë 14.05.2003.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 761, datë 18.06.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Elbasan duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të praktikës shkresore/procedurës së ndjekur nga ana juaj, lidhur me rastin e fëmijës F.T.
 - Informacion, statistika, nëse ka praktika të njëjta apo të ngjashme për persona të ndodhur në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin, për të cilët nga ana juaj është ndjekur e njëjta praktikë. Kopje të praktikave të ngjashme. (Për subjekte të cilët kanë të njëjtën diagnozë si ankuesi/procedura e ndjekur prej jush për raste specifike).

Me shkresën nr. 312/1, datë 30.06.2020, DRSHTSH Elbasan në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“F.T, i datëlindjes 14.05.2003, lindur në Librazhd dhe me gjendje civile aktuale në Njësinë Qendër të Bashkisë Librazhd, ka qenë përfitues i pagesës së aftësisë së*

kufizuar nga viti 2008 deri në dhjetor 2019, me diagnozë “Prapambetje mendore (e moderuar) me surdomutizëm”, grupi i dytë. KMCAP Rajonal Elbasan mori në rishqyrtim dosjet e personave me aftësi të kufizuar me diagnozë “Prapambetje Mendore” të cilët përfitonin 200% dhe 300% të pagesës bazë, ndër të cilët dhe dosjen e F.T. Në rastin e F.T sqarohet se diagnoza e cila përbën shkak për marrjen në rishqyrtim është “Prapambetja Mendore” dhe jo “surdomutizmi” në vetvete. KMCAP Rajonal mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur, si dhe duke mos patur mundësi për t’u vlerësuar gjendja e tij aktuale shëndetësore për shkak të mos paraqitjes në Komision të vetë personit e ka vlerësuar pa grup duke rekomanduar rivlerësimin e gjendjes reale të tij në KMCAP Epror të Sëmundjeve Mendore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH Tiranë. Dosja është përcjellë në DPSHSSH Tiranë dhe aktualisht ndodhet në pritje për rivlerësim nga KMCAP Epror përkatës. Bazuar në Urdhërin nr. 47/1, datë 11.01.2018 “Për miratimin e Rregullores për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAP për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”, personi nuk paraqitet fizikisht përpara këtij Komisioni, por vlerësohet dosja përkatëse. Gjithashtu informohet se në të njëjtën situatë me F.T janë gjendur dhe 30 dosje të tjera të rivlerësuar me diagnozë bazë “prapambetje mendore” të cilat gjithashtu trajtoheshin me 200/300% dhe për të cilat KMCAP Rajonal ka marrë të njëjtin vendim “pa grup” dhe që gjithashtu i kemi orientuar për rivlerësim nga Kempia Epror përkatës. Konkretisht mund të vënë në dijeni për dy raste të njëjta/ngjashme të cilët janë ndodhur në të njëjtat kushte me ankuesin dhe për të cilët është ndjekur e njëjta praktikë nga ana e KMCAP Rajonal Elbasan: 1. S.R, i datëlindjes 05.09.2002, lindur në Librazhd dhe banues në Njësinë Administrative Hotolisht, Librazhd. Diagnoza “prapambetje mendore e shkallës së mesme”, 2. A.P, lindur në Xhyrë dhe banues në Njësinë Administrative Hotolisht, Librazhd. Diagnoza “prapambetje mendore e moderuar””.

- Me shkresën nr. 739/1, datë 09.07.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion shtesë nga DRSHSSH Elbasan, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Shpjegime përse F.T nuk përfiton KMCAP vetëm për diagnozën “surdomutizëm” dhe arsyet e ndërprerjes së përfitimit të KMCAP-së për diagnozën “prapambetje mendore”.
 - Kopje të plotë të dosjes së F.T, në të cilën të përfshihet dhe vendimi i KMCAP Rajonal, kopje të kundërshtimit të vendimit të ankuesit, kopje të shkresës shoqëruese të dosjes nga DRSHSSH Elbasan drejtuar KMCAP-it Epror. Nëse nuk dispononi kopje të dosjes, ju lutem të citoni bazën ligjore mbi të cilën veproni duke mos disponuar kopje të dosjes në institucion.
 - Kopje të plotë të Urdhërit nr.47/1, datë 10.01.2018 “Për miratimin e Rregullores për Organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAP për Vlerësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”.

- Kopje të dosjeve të personave të cituar në shkresën tuaj nr.312/1, datë 30.06.2020: S.R dhe A.P.

Me shkresën nr. 312/3, datë 16.07.2020, DRSSSH Elbasan në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Diagnoza bazë e F.T është “prapambetje mendore” dhe kjo është e shoqëruar me “surdmutizëm”, për diagnozën “surdmutizëm” në vetvete ankuesi nuk mund të përfitojë, pasi si diagnozë përfiton deri në moshën 7 vjeç, mbi këtë moshë përfiton vetëm kur ka diagnozë shoqëruese, bazuar kjo në kriteret mjekësore të përcaktuara nga MSHMS. Arsyeja e ndërprerjes së përfitimit të KMCAP-së për diagnozën “prapambetje mendore” është se KMCAP Rajonal e ka vlerësuar pa grup. Arsyeja e këtij vlerësimi është se KMCAP Rajonal nuk ka patur mundësi për t’a vlerësuar gjendjen e tij aktuale shëndetësore për shkak të mosparaqitjes në komision të vetë personit, ndaj dhe është rekomanduar rivlerësimi i gjendjes reale të tij në KMCAP Epror të Sëmundjeve Mendore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH Tiranë. Bazuar në Urdhërin nr. 47/1, datë 11.01.2018 “Për miratimin e Rregullores për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAP për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”, kreu IV, pika 1, përcaktohet se dosja me dokumentacionin e plotë të personit me aftësi të kufizuar sistemohet në praktikën e tij të veçantë, mbahet dhe ruhet në Njësinë Administrative/Bashkitë ku ka vendbanimin individ. Në rastin konkret, dosja e plotë e F.T gjendet në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH në Tiranë, sikurse dhe dosjet e tjera të dërguara për rivlerësim”.*

- Me shkresën nr. 739, datë 09.07.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion profesional nga KMCAP Epror, Instituti Kombëtar i Nxënësve që nuk Dëgjojnë dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), lidhur me kufizimet që mund të kenë personat të cilët kanë diagnozën “Surdmutizëm”, dhe në ç’farë aspekti të jetës së përditshme janë të pamundur, kanë barriera, apo nuk mund të ushtrojnë një jetesë të pavarur. Instituti Kombëtar i Nxënësve që nuk Dëgjojnë nuk ka kthyer përgjigje lidhur me informacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Me shkresën nr. 1021/1, datë 12.08.2020, Drejtoria e Komisionit të PAK të SHSSH në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Bazuar në Urdhërin e Ministrit nr. 362, datë 26.02.2007 “Për miratimin e Rregullores për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar”, Kreu XII, Sëmundjet e ORL, pika 1, përcaktohet se: “Surdmutizmi” përfiton deri në moshën 7 vjeç dhe mbi këtë moshë përfiton vetëm kur ka diagnozë shoqëruese si deficiet mendor. Sqarohet se nëse një i sëmurë me “surdmutizëm” paraqet probleme me shëndetin mendor kjo duhet vërtetuar dhe ndjekur nga “Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor”. Bazuar në Urdhërin nr. 47/1, datë 11.01.2018 “Për miratimin e Rregullores për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAP për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”, dosja e plotë e F.T gjendet në DPSHSSH për rivlerësim nga KMCAP Epror i Specializuar i Shëndetit Mendor por për arsyen e pandemisë Covid-19 komisionet janë pezulluar sipas Urdhërit të Ministres nr. 226, datë 02.04.2020. Informojmë se në*

momentin e rihapjes së KMCAP-ve F.T do njoftohet zyrtarisht dhe nëse rezulton përfitues do ta përfitojë pagesën që nga momenti i ndërprerjes”.

- Me shkresën nr. 7393, datë 26.08.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me arsyet se: - Përse personat që janë mbi moshën 7 vjeç, të cilët kanë diagnozën “Surdomutizëm”, nuk janë në kushtet e përfitimit si persona me aftësi të kufizuar, dhe - Si bëhet vlerësimi biopsikosocial i personave me diagnozën “Surdomutizëm”.

Në përgjigje të informacionit të kërkuar, Drejtoria e Komisionit të PAK të SHSSH, me shkresën nr. 1127, datë 02.09.2020, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Personat me diagnozë “surdomutizëm” përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar deri në moshën 7 vjeç, kjo e përcaktuar në Urdhërin e Ministrisë nr. 362, datë 26.02.2007 “Për miratimin e Rregullores për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar”, Kreu XII, Sëmundjet e ORL, pika 1, përcaktohet se: “Surdomutizmi” përfiton deri në moshën 7 vjeç dhe mbi këtë moshë përfiton vetëm kur ka diagnozë shoqëruese si deficiet mendor. Vlerësimi Bio-psiko-social realizohet nga komisionet shumëdisiplinore të aftësisë së kufizuar dhe konsiston në përcaktimin e nivelit të funksionimit. Diagnoza “surdomutizëm” është e përfshirë në udhëzuesin Bio-psiko-social. Aplikanti që kërkon të përfitojë pagesën e aftësisë së kufizuar pajiset me dokumentacionin e duhur mjekësor nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist të cilin e dorëzon në zyrën e vlerësimit pranë komisionit shumëdisiplinor ku dhe do të bëhet vlerësimi. Aktualisht vlerësimi Bio-psiko-social aplikohet vetëm në qarkun e Tiranës dhe ju informojmë se janë në pritje që të shtrihet dhe në rrethin e Durrësit dhe Elbasanit”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të pabarabartë nga ana e Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Elbasan.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Referuar dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, subjekti ankues, në vitin 2008 është konstatuar nga komisioni mjekësor i kabinetit neuropsikiatrisë të Poliklinikës Librazhd, se vuante prej prapambetjes mendore të lehtë me çrregullime të shprehura të sjelljes, surdomutizëm dhe është rekomanduar për tu drejtuar KMCAP-së për përfitimin e ndihmës ekonomike³. Referuar shkresës Vërtetim datë 09.06.2020 të lëshuar nga Shkolla e Mesme Artistike “Onufri”, Elbasan, vërtetohet se F.T për vitin shkollor 2019-2020 ka ndjekur mësimet në klasën e XI-të dhe ka vijuar normalisht mësimet në profilin e përgjithshëm dhe atë artistik, sillet mirë me shokët e klasës dhe mësuesit.

³ Referuar dokumentit, Fletë drejtimi për KMCAP, nr.351, datë 14.04.2008 të lëshuar nga Poliklinika Librazhd.

Referuar dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, në cilësinë e provës, F.T është diagnostikuar me “prapambetje mendore (e moderuar). Surdomutizëm” dhe referuar korrespondencës zyrtare me DRSHSSH Elbasan, ai ka përfituar të ardhura për invaliditet të grupit të dytë, si person me aftësi të kufizuar nga viti 2008, deri në muajin dhjetor 2019.

Me Vendimin nr. 7238, datë 21.11.2019, KMCAP Elbasan e ka cilësuar ankuesin, jo përfitues, pa grup invaliditeti. Ankuesi nuk ka rënë dakord me vendimin dhe ka bërë rekurs në KMCAP-in Epror të Sëmundjeve të Shëndetit Mendor. Dosja e ankuesit me shkresën nr. 83/3, datë 03.02.2020 është dërguar nga DRSHSSH Elbasan drejt KMCAP-it Epror të Sëmundjeve të Shëndetit Mendor në Tiranë. Ankesa e F.T nuk është shqyrtuar, pasi për shkak të pandemisë Covid-19, puna e KMCAP-ve është pezulluar me Urdhëri nr. 226, datë 02.04.2020 të MSHMS.

Në Rregulloren “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e KMCAP për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”, miratuar me Urdhërin nr. 47/1, datë 11.01.2018, Kreu III/1, pika 3, përcaktohet se: “Mjeku i DRSHSSH merr me procesverbal nga protokoll i Drejtorisë Rajonale praktikën e kompletuar të dosjeve që vlerësohen për herë të parë, bën verifikimet e nevojshme të dokumentacionit mjekësor, dhe brenda 30 ditëve KMCAP-i shqyrton dosjen. Në rivlerësimin e dosjeve, mjeku i DRSHSSH merr me procesverbal nga administratori shoqëror dokumentacionin e plotë ekzistues si dhe Epikrizën përcjellëse, e cila shoqërohet me analiza dhe ekzaminime, me përgjigje zyrtare të interpretuara nga mjeku specialist, që janë të domosdoshme për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të tij”.

Referuar në sa më sipër, vlerësohet se KMCAP-ja Rajonale Elbasan, bazuar në urdhrin e mësipërm vlerëson vetëm dosjen e aplikuesve dhe nuk ka kontakt me personat aplikues për të vlerësuar gjendjen aktuale shëndetësore të tyre.

Në pikën I/1, të VKM-së nr. 618, datë 07.09.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, (i ndryshuar) përcaktohet se: “Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar”. Ndërsa në pikën I/4 përcaktohet se: “Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, bëhet nga KMCAP-i, i cili është i ngritur dhe funksionan pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku merr pjesë, si anëtar me të drejtë vote, edhe mjeku, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror”.

Sikurse vihet re nga parashikimi i pikës I/1 & 4, të VKM-së nr. 618, datë 07.09.2006, janë KMCAP-të ato, të cilat bëjnë vlerësimin e gjendjes shëndetësore të personit me aftësi të kufizuar, nëse ai mund të përfitojë pagesë aftësie të kufizuar.

Në pikën II/9, të VKM-së nr. 618, datë 07.09.2006, përcaktohet masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar. *“Personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të cilët ndjekin arsimin e mesëm, me apo pa shpëtim nga puna, apo kurse kualifikimi, përfitojnë 14000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj”.*

Mbështetur në pikën I/6 të VKM nr. 618, datë 07.09.2006 *“Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”,* i ndryshuar, i referohemi një akti tjetër tepër të rëndësishëm nënligjor, pikërisht Urdhërit nr. 362, datë 26.02.2007 të Ministrit të Punëve dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrit të Shëndetësisë *“Për miratimin e rregullores për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar”.* Ky akt nënligjor merr përsipër të rregullojë në mënyrë të hollësishme, kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Në pikën XI: *“Diagnozat në psikiatrinë e fëmijëve dhe adoleshentëve”,* të Rregullores së mësipërme, përcaktohen diagnozat përkatëse, si më poshtë vijojnë:

1. *Prapambetje mendore e lehtë e diagnostikuar në përputhje me Klasifikimet Ndërkombëtare të Çrregullimeve Psikiatrike (ICD, DSM-IV) kur shoqërohen me një nga situatat e mëposhtme: -Turbullime të theksuara të sjelljes, - Çrregullim i vëmendjes së pamjaftueshme në hiperaktivitet, - Epilepsi.*

Individët e këtij grupi zhvillojnë aftësi sociale dhe komunikative në moshën parashkollore, kanë dëmtime minimale në fushat senso-motore dhe mund të fitojnë aftësi akademike të nivelit të shkollës fillore. Janë në gjendje të plotësojnë nevojat e vetës, veçanërisht në situatë sociale ...etj. Vlerësimi: a) janë në kushtet e përfitimit si persona me aftësi të kufizuar përgjithmonë.

2. *Prapambetje mendore e shkallës së mesme e diagnostikuar në përputhje me Klasifikimet Ndërkombëtare të Çrregullimeve Psikiatrike (ICD, DSM-IV). Janë individë që në vitet e para të jetës fitojnë një nivel të moderuar të aftësive komunikative dhe që në mbështetjen e nevojshme arrijnë të marrin pjesë në plotësimin e nevojave të tyre personale. Nëpërmjet programeve specifike të trajnimit, aftësohen në aspekte sociale dhe okupacionale, por niveli akademik mbetet në nivelin parashkollor apo në nivel fillestar shkollor...etj. Vlerësimi: a) janë në kushtet e përfitimit si persona me aftësi të kufizuar përgjithmonë.*

Në Kreu XII: *“Sëmundjet e ORL”* pika 1, përcaktohet se: 1. *“Surdmutizmi. Vlerësimi: a) janë në kushtet e përfitimit si persona me aftësi të kufizuar përgjithmonë rastet me deficiet mendor. b) janë në kushtet e përfitimit si persona me aftësi të kufizuara pa deficiet mendor deri në moshën 7 vjeç”.*

Sikurse vihet re nga parashikimi i Rregullores *“Për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar”,* përfitojnë pagesë si persona me aftësi të kufizuar vetëm ata individë që kanë

prapambetje mendore dhe kjo e shoqëruar me surdomutizëm, diagnozë kjo që nuk i është dhënë F.T, nga KMCAP Rajonal Elbasan.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se diagnoza e subjektit ankues, “surdomutizëm” nuk mund të merret në shqyrtim, pasi nuk ka dokumentacion për të provuar se ankuesi ka shfaqur komplikacione të prapambetjes mendore.

Bazuar në informacionin e dërguar nga DRSHSSH Elbasan⁴, vërtetohet se nga ana e KMCAP Rajonal Elbasan është mbajtur i njëjti qëndrim dhe në shqyrtimin e praktikave dhe të personave të tjerë (S.R dhe A.P) të diagnostikuar me prapambetje mendore të moderuar dhe të shkallës së mesme. Nga ana tjetër, në vijim të komunikimit, subjekti ankues nuk solli prova që të mund të mbështeste pretendimin se persona të tjerë në kushte të njëjta me të, janë favorizuar nga KMCAP-i Rajonal Elbasan.

Gjithashtu, theksohet fakti⁵, që ankuesi vijon normalisht mësimin në profilin e përgjithshëm dhe atë artistik në klasën e XI-të dhe ka sjellje të mirë me shokët e klasës dhe mësuesit.

Sa më sipër, mbështetur në Ligjin nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se F.T nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, nga ana e KMCAP Rajonal Elbasan, për shkak të gjendjes shëndetësore.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Neni 7 i LMD-së⁶, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

⁴ Referuar shkresës nr. 312/1, datë 30.06.2020.

⁵ Referuar shkresës datë 09.06.2020 të Shkollës së Mesme Artistike “Onufri” Elbasan.

⁶ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të Ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga ana e KMCAP Rajonal Elbasan, lidhur me trajtimin e rastit të F.T. Në mungesë të trajtimit të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të djalit të S.T, nga ana e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan, për shkak të gjendjes shëndetësore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja djeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA